



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1382 / 6 prot.

Tiranë, më 02.12.2024

V E N D I M

Nr. 293, datë 02.12.2024

Mbështetur në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është paraqitur ankesa nr. 202 Regj., datë 08.10.2024, që i përket ankueses znj.E.H , kundër Cirkut Kombëtar, z. L.Y , në cilësinë si ish Drejtor i Cirkut Kombëtar dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja E.H parashtron se:

E gjithë situata filloi në muajin Korrik ku ish titullari dërgon një *email* për mbledhje bordi, ku ankuesja në mbledhjen e bordit është si përfaqësuese Sindikate, si Kryetare. Në këtë mbledhje do të përcaktoheshin disa ngritje në kategori dhe caktimi i disa mjeshtrove.

Titullari nisi një procedurë të gabuar duke mbledhur thjesht bordin e drejtorit pa zbatuar asnjë procedurë të parashikuar nga neni 4.7 i rregullores së re provizore, me pretendimin se ai po procedonte me rregulloren e vjetër, pasi rregulloren e re nuk e kishte miratuar ende Ministria. Por, edhe në rregulloren e vjetër, përcaktohet se për ngritjen në kategori propozon Drejtuesi Artistik dhe më pas vendos drejtori, gjë të cilën edhe në këtë rast nuk e respektoi. Pas shumë debatesh, mbledhja u mbyll, duke propozuar disa mjeshtro dhe vetë titullari dolën me vendim të disa emrave.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Mbledhja është pasqyruar në procesverbal, të cilin ankuesja deklaron se nuk e ka firmosur pasi në të nuk ishin pasqyruar fjalët, opinionet dhe mendimet e saj.

Pas një debati me *e-maile* thirremi sërish edhe në dy mbledhje të tjera gjatë muajit gusht, për të dalë në konkluzione dhe vendime mbi kërkesat e drejtorit. Sërish edhe këto procesverbale janë të njëanshme dhe nuk janë pasqyruar mendimet e ankueses, e cila deklaron se nuk i ka firmosur. Nga ky moment kanë filluar edhe diskutimet e mëtejshme me titullarin duke i thënë shpesh se ajo më tepër ishte si Kryetare Sindikate dhe jo si Mjeshtre.

Më datën 16.09.2024 ora 14:27, ankuesja parashtroi se i ka ardhur një *email* nga specialistja e institucionit, ku bëhet me dije për shkresën nr. 254 prot datë 13.09.2024: “*Njoftim për kryerjen e bisedimeve mbi vijimësinë e marrëdhënieve të punës*”, sipas të cilës duhet të paraqitej më datë 17.09.2024, ora 09:00, në ambientet e punës, bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës. Sipas ankueses kjo shkresë nuk ka asnjë argumentim se çfarë shkeljesh kishte bërë, për më tepër që ajo në datën 16.09.2024 deri në datën 19.09.2024 ka qenë me raport mjekësor. Përpos lajmërimit me vonesë, më datë 17.09.2024 ora 12:10, ankuesja deklaron se ka marrë një *email* nga specialistja e institucionit, konkretisht urdhri nt.62, nr.257 prot, datë 16.09.2024 ku thuhet: “*Ky njoftim do ju jepej sot në mbledhje sipas njoftimit përkatës, por duke qenë se ju nuk erdhët për arsye shëndetësore, po e nis me email urdhrin nr.62, datë 16.09.2024 “Për marrjen e masës disiplinore” “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për znj. E.H , me motivacionin “Thyerje e rëndë e disiplinës në punë, përdorimin e emrit të institucionit pa autorizim, shkelje e detyrave funksionale, shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë kontraktore mes punëdhënësit dhe punëmarrësit”*. Sipas këtij urdhri është vendosur heqja e funksionit nga detyra si Mjeshtër Profili (Zhonglerimit) për ankuesen dhe ulja nga kategoria e parë në kategorinë e dytë. Pra, pa kaluar 72 orë dhe pa u bërë seanca dëgjimore titullari ka dalë me këtë vendim.

Ankuesja parashtroi gjithashtu se si Kryetare e Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Cirkut Kombëtar, titullari i ka sjellë një shkresë për të kryer bisedime për ndryshime mbi kontratën kolektive në formë presioni, përkatësisht shkresa nr.245 prot datë 12.09.2024. Ankuesja e ka kundërshtuar urdhrin nr.62, datë 16.09.2024, të Drejtorit të Cirkut Kombëtar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, por ministria nuk e ka anuluar urdhrin për marrjen e masës disiplinore ndaj saj.

Sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ana e Cirkut Kombëtar, në cilësinë e punëdhënësit të saj, z. L.Y si ish titullar i Cirkut Kombëtar, i cili ka vepruar në mënyrë të gabuar duke dhënë masën disiplinore pa i dhënë mundësinë të dëgjohej, si dhe kundër Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe shfuqizimin e akteve të pabazuara në ligj dhe në kundërshtim me procedurat ligjore, rregulloren e brendshme të institucionit dhe kontratën kolektive të punës dhe rikthimin e saj në pozicionin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit”, pika 1, gërma “c”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr.202 datë 08.10.2024, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj. Me anë të e-mailit datë 09.10.2024, ankueses i'u kërkua plotësimi i ankesës, veçanërisht në drejtim të shkakut të pretenduar të diskriminimit “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe subjekteve kundër të cilëve drejtohet ankesa. Ankuesja plotësoi dhe saktësoi ankesën, nëpërmjet emailit të datës 15.10.2024.

Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1382/1 prot., datë 22.10.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Cirku Kombëtar, z. L.Y , në cilësinë si ish Drejtor i Cirkut Kombëtar dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në cilësinë e subjekteve kundër të cilëve është drejtuar ankesa.
 - 1.1 Me shkresën nr. 327/1 prot., datë 04.11.2024², Cirku Kombëtar ktheu përgjigje në lidhje me ankesën duke depozituar dokumentacionin përkatës.
 - 1.2 Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr. 1382/4 prot., datë 12.11.2024, z. L.Y , ktheu përgjigje në lidhje me ankesën duke depozituar dokumentacionin përkatës.
2. Në vijim, me *emailin* e datës 21.11.2024, ankuesja E.H , ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi ajo është rikthyer në pozicionin e saj të punës dhe në këto kushte ankesa që ajo ka paraqitur pranë Komisionerit është zgjidhur. Nëpërmjet këtij *emaili*, ankuesj ka vendosur në dispozicion të Komisionerit urdhrin nr. 88, datë 18.11.2024, të Drejtorit të Cirkut Kombëtar “Për anulimin e urdhrin nr. 62, datë 16.09.2024 “Për marrjen e masës disiplinore”, për znj.E.H”. Me anë të këtij urdhri, është vendosur anulimi i urdhrin nr. 62, datë 16.09.2024 “Për marrjen e masës disiplinore”, për znj.E.H dhe është urdhëruar rikthimi i saj në pozicionin e mëparshëm të punës.

Në këtë situatë, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1382/2 prot., datë 06.11.2024.

përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga znj. E.H , e cila me anë të kërkesës, datë 21.11.2024 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pikat 9 e 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 202, datë 08.10.2024, të paraqitur nga ankuesja znj.E.H , kundër Cirkut Kombëtar, z. L.Y , në cilësinë si ish Drejtor i Cirkut Kombëtar dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shëndetësore, përkatësia në një grup të veçantë.
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti